

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

Datë: 12.09.2025

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 10.09.2025, pas shqyrtimit të Kërkesës me Nr. 02-070/05-0027034/25, të datës 04.08.2025, të paraqitur nga pala Skender Zenel Krasniqi nga fshati Miradi e Epërme, bazuar në nenin 11, nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (c), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 27, shkronja (ç), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, nenin 13, paragrafi 3, të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr. 83, të datës 14.06.2013, mori:

V E N D I M

**Për aprovimin e Kërkesës Nr. Nr. 02-070/05-0027034/25, të datës 04.08.2025, për
lejimin e mjeteve financiare për shërim dhe trajtim shëndetësorë**

1. Për aprovimin e Kërkesës Nr. Nr. 02-070/05-0027034/25, të datës 04.08.2025, për lejimin e mjeteve financiare në shumë prej: 5,000.00€, për shërim dhe trajtim shëndetësorë, për palën Skender Zenel Krasniqi nga fshati Miradi e Epërme, i cila vuan nga sëmundja e rëndë me Dg: 'Carcinoma skuamoze grada II - bronku principal sinister', të cilit i duhet trajtim i vazhdueshëm shëndetësorë për shërim dhe rehabilitim.
2. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për sigurimin e mjeteve financiare nga nën - programi i Administratës së Shëndetësisë me Nr. 73011, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës, Drejtorisë së Financave e Buxhetit dhe Drejtorisë së Shëndetësisë e Mirëqenies Sociale.
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së FB, Drejtorisë së SHMS, Palës dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Ali Ismaili





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

Datë: 23.09.2025

Kuvendi i Komunës së Fushë-Kosovës në mbledhjen e mbajtur me datën 18.09.2025 dhe vazhduar me datën 22.09.2025, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 1537, të datës 29.08.2025, të Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (d), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (b), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 61, paragrafi 61.2, të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi Nr. 03/L-048, nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (ç), nenin 27, shkronja (c), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për aprovimin e Buxhetit të Planifikuar të Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2026


1. Për aprovimin e Buxhetit të Planifikuar të Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2026, në shumë të përgjithshme prej: 26,803,586.00€, i shpërndarë nëpër programe e nënprograme të kategorive ekonomike si vijon:
 - 1.1 Për paga dhe shtesa për 1124 të punësuar në Administratën Komunale, Arsim dhe Shëndetësi, buxheti i komunës është në shumë prej: 10,600,536.00€;
 - 1.2 Për mallra dhe shërbime, buxheti i komunës është në shumë prej: 3,057,122.00€;
 - 1.3 Për shpenzime komunali, buxheti i komunës është në shumë prej: 428,400.€;
 - 1.4 Për subvencione dhe transfere, buxheti i komunës është në shumë prej: 1,708,751.00€ dhe
 - 1.5 Për shpenzime në projekte kapitale, buxheti i komunës është në shumë prej: 11,008,777.00€.
2. Vlerësimet e hershme të cekura me kufijtë për buxhetin e planifikuar me Kornizën Afatmesme Buxhetore për vitin fiskal 2027 është në shumë të përgjithshme prej: 28,359,191.00€ dhe për vitin fiskal 2028 është në shumë të përgjithshme prej: 29,765,823.00€.
3. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera, mbështetur në tabelat buxhetore për Buxhetin e vitit 2026 për secilën kategori ekonomike të shpenzimeve, të planifikuara dhe të përshkruara në paragrafin një dhe dy të këtij vendimi dhe zbatimi i tij, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së FB, Drejtorive të Komunës dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Ali Ismaili





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

Datë: 23.09.2025

Kuvendi i Komunës së Fushë-Kosovës në mbledhjen e mbajtur me datën 18.09.2025, e vazhduar me datën 22.09.2025, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 953, të datës 04.09.2025, të paraqitur nga Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (d), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (c) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 8 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr. 03/L-049, (Gazeta Zyrtare Nr. 27/2008), nenin 6, paragrafi 2 i Ligjit Nr. 08/L-332 mbi Ndarjen Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (ç), nenin 27, shkronja (ç), nenin 54 të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për rritjen e të hyrave vetanake në buxhetin e Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2025

1. Për rritjen e të hyrave vetanake për vitin fiskal 2025 në buxhetin e Komunës së Fushë-Kosovës, në shumën e mjeteve financiare prej: 2,000,000.00€, të shpërndara nëpër kategoritë ekonomike buxhetore: paga e shtesa, mallra e shërbime dhe investime kapitale nëpër kodet buxhetore të programeve, nënprogrameve dhe projekteve si vijon:
 - 1.1 Mjetet financiare në shumë prej: 15,000.00€, lejohen për shpenzim në kategorinë ekonomike paga dhe shtesa, në kodin e nënprogramit Shkolla e Mesme Teknike 'Minatori' me numër 94231, kodi funksional 0922 dhe
 - 1.2 Mjetet financiare në shumë prej: 5,000.00€, lejohen për shpenzim në kategorinë ekonomike paga dhe shtesa, në kodin e nënprogramit Shkolla e Mesme Ekonomike 'Hoxhë Kadri Prishtina' me numër 94232, kodi funksional 0922.
 - 1.3 Mjetet financiare në shumë prej: 200,000.00€, lejohen për shpenzim në kategorinë ekonomike mallra dhe shërbime, në kodin e nënprogramit Infrastruktura Publike me numër 18162.
 - 1.4 Mjetet financiare në kodin e nënprogramit - Buxhetimi - me numër 17502, lejohen për shpenzim në kategorinë ekonomike për projekte në investime kapitale, në shumën e mjeteve financiare prej: 622,500.00€, në projektin 'Bashkëfinancimi i projekteve të ndryshme sipas prioritetit të komunës, impianti i ujërave të zeza dhe projektet nga donatorët dhe Ministrinë e linjës', kodi i projektit me Nr. 54403, ndërmjet Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor e Infrastrukturës dhe Komunës së Fushë-Kosovës dhe Marrëveshjes në mes Ministrisë së Ekonomisë/Kur Prishtina dhe Komunës së Fushë-Kosovës me kontributin e saj.
 - 1.5 Mjetet financiare në kodin e nënprogramit - Infrastruktura Rrugore - me numër 18002, lejohen për shpenzim në kategorinë ekonomike për projekte në investime kapitale, në shumën e mjeteve financiare prej: 190,000.00€, në projektin 'Asfaltimi në Fushë Kosovë Rr. 'Hajrullah Zymi', me infrastrukturë përcjellëse: kanalizim, trotuar dhe ndriçim, kodi i projektit me Nr. 54261 dhe

- 1.6 Mjetet financiare në kodin e nënprogramit - Infrastruktura Rrugore - me numër 18002, lejohen për shpenzim në kategorinë ekonomike për projekte në investime kapitale, në shumën e mjeteve financiare prej: 191,000.00€, në projektin 'Rregullimi në Rr. 'Dardania' në Fushë-Kosovë: trotuar, ndriçim, largimi i terrasave, sinjalizim, infrastruktura elektrike, faza e parë, kodi i projektit me Nr. 55992.
- 1.7 Mjetet financiare në kodin e nënprogramit - Infrastruktura Publike - me numër 18162, lejohen për shpenzim në kategorinë ekonomike për projekte në investime kapitale, në shumën e mjeteve financiare prej: 116,333.42€, në projektin 'Ndërtimi i kanalizimeve dhe ujësjellësit në fshatrat: Harilaç, Graboc i Poshtëm dhe Fushë-Kosovë, lagjen 028, kodi i projektit me Nr. 56231.
- 1.8 Mjetet financiare në kodin e nënprogramit - Planifikimi Hapësinor dhe Rregullativ - me numër 66015, lejohen për shpenzim në kategorinë ekonomike për projekte në investime kapitale, në shumën e mjeteve financiare prej: 660,166.58€, në projektin 'Ndërtimi i kanalizimeve dhe ujësjellësit në fshatra dhe qytet', kodi i projektit me Nr. 49732.
2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është dokumenti financiar i përgatitur nga Drejtoria e Buxhetit dhe Financave prej dy faqeve.
3. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi është në kompetencë të Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

A r s y e t i m

- Për paga dhe shtesa - mësimi joformal që nga përcaktimi i Ligjit të Arsimit dhe Aftësimin për të Rritur', me Nr. 02/L-24, të vitit 2007 dhe Ligjit të Arsimit me Nr. 04/L-143 për Aftësim për të Rritur në Republikën e Kosovës, të vitit 2014, ku obligohet çdo komunë të organizoj mësimin për kandidatët të cilët nuk kanë mundur të mbarojnë shkollën e mesme profesionale në profile të ndryshme, për pagesën e profesorëve për mësim joformal jemi të obliguar si komunë të plotësojmë këtë kategori me mjete financiare nga të hyrat vetanake të vitit 2025.
- Për mallra dhe shërbime - do të plotësohet mungesa e mjeteve financiare në shumën e mjeteve financiare prej 200,000.00€, për arsye të buxhetit jo të mjaftueshëm për pagesën e obligimeve - faturave 2025 dhe për mirëmbajtjen e qytetit, varrezave, pastrimin e rrugëve, mirëmbajtjen e rrugëve gjatë sezonës verore dhe dimërore.
- Për obligimet kontraktuale - Bashkëfinancimi në projekte të ndryshme sipas prioritetit të komunës, kodi me Nr. 54403 në shumën e mjeteve financiare prej: 622,500.00€, do të plotësohet shuma për të realizuar Memorandumin e Mirëkuptimit për financimin e projekteve infrastrukturore në mes Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunës së Fushë-Kosovës, si dhe Marrëveshja në mes të Ministrisë së Ekonomisë/Kur Prishtina dhe Komunës së Fushë-Kosovës me kontributin e saj.
- Asfaltimi në Fushë-Kosovë Rr. 'Hajrullah Zymeri', me infrastrukturë përcjellëse: kanalizim, trotuar dhe ndriçim, kodi me Nr. 54261, në shumën e mjeteve financiare prej: 190,000.00€, për

arsye se thesari në këtë projekt kapital ka ekzekutuar vendime gjygjësore gjatë vitit 2025, andaj jemi të obliguar që këto shuma të mjeteve financiare, t'i plotësojmë nga të hyrat vetanake për vitin 2025.

- Rregullimi në Rr. 'Dardania' në Fushë-Kosovë për: trotuare, ndriçim, largimi I terrasave, sinjalizim, infrastruktura elektrike, faza e parë, kodi me Nr. 55992, në shumën e mjeteve financiare prej: 191,000.00€, për arsye se thesari në këtë projekt kapital ka ekzekutuar vendime gjygjësore gjatë vitit 2025, andaj jemi të obliguar që këto shuma të mjeteve financiare, t'i plotësojmë nga të hyrat vetanake për vitin 2025.

- Ndërtimi i kanalizimeve dhe ujësjellësit në fshatrat: Harilaç, Graboc i Poshtëm dhe në Fushë-Kosovë, lagjen 028, kodi me Nr. 56231, në shumën e mjeteve financiare prej: 116,333.42€, një pjesë e mjeteve financiare është ekzekutuar nga thesari nga ky projekt kapital për vendime gjygjësore gjatë vitit 2025, andaj jemi të obliguar që këto shuma të mjeteve financiare, t'i plotësojmë nga të hyrat vetanake për vitin 2025.

- Ndërtimi i kanalizimeve dhe ujësjellësit në fshatra dhe qytet, kodi me Nr. 49732, në shumën e mjeteve financiare prej: 660,166.58€, ky është projekt tre vjeçarë i planifikuar nga të hyrat vetanake, andaj për realizimin e këtij projekti duhet plotësuar shuma e mjeteve financiare nga të hyrat vetanake për vitin 2025.

**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës,
Drejtorisë së FB, Drejtorive tjera të Komunës dhe Arkivës.**

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Ali Ismaili





03.09.2025


	Kodi Funksion al	Planifikimi i THV 2025	Te pa alokuara deri me tani per shkak te kodit funktional	Tejkalimi i THV 2025	Total Buxheti per THV 2025
Shpermdarja e THV 2025 sipas tabelave:					
Rritja e buxhetit nga te hyrat vetanke 2025		3,459,675.00	811,000.00	2,000,000.00	5,459,675.00
11 PAGA DHE SHITESA		-	-	20,000.00	20,000.00
94231 Shkolla e mesme teknike Minatori	0922	-	-	15,000.00	15,000.00
94232 Shkolla e mesme ekonomike H.K Prishtina	0922	-	-	5,000.00	5,000.00
13 MALLRA DHE SHËRBIME - FUSHË KOSOVË		-	-	200,000.00	200,000.00
18162 Infrastruktura publike	0451	-	-	200,000.00	200,000.00
20 SUBVENCIONE DHE TRANSFERE - FUSHË KOSOVË		1,298,675.00	-	-	1,298,675.00
16002 ZYRA E KRYETARIT	0111	30,000.00	-	-	30,000.00
16502 ÇËSHTJE GJINORE	0421	10,000.00	-	-	10,000.00
18162 INFRASTRUKTURA PUBLIKE	0451	90,000.00	-	-	90,000.00
19710 ZKK	1090	3,000.00	-	-	3,000.00
47042 ZHVILLIMI RURAL DHE INSPEKSIONI I BUJQËSISË	0421	200,000.00	-	-	200,000.00
48002 PLANIFIKIMI DHE ZHVILLIMI EKONOMIK	0411	60,000.00	-	-	60,000.00
73011 ADMINISTRATA Shëndetësi	0760	290,000.00	-	-	290,000.00
75506 Shërbimet Sociale-Fushë Kosovë	1040	10,000.00	-	-	10,000.00
85002 Shërbimet kulturore	0820	230,675.00	-	-	230,675.00
92010 Administrata Arsimit	0980	375,000.00	-	-	375,000.00
30 PASURITË JOFINANCIARE - FUSHË KOSOVË		2,161,000.00	811,000.00	1,780,000.00	4,752,000.00
16302 Administrata	0133				
55834 Blerja e makinave për pastrim të dyshemeve në objektet e Administratës, Shëndetësisë dhe Arsimit		10,000.00	-	-	10,000.00
17502 Buxhet dhe financa	0112				
54403 Bashkefinancimi i projekteve të ndryshme sipas prioritetit të Komunes, impianti i ujërave të zeza, dhe projektet nga Donatorët dhe Ministrat e Linjës		-	-	622,500.00	622,500.00
18002 Infrastruktura rrugore	0451				
54261 Asfaltimi në Fushë-Kosovë Rr.Hajrullah Zymi me infrastrukturë perçeluese (trotauret,ndriqimi,kanalizimi)		10,000.00	-	190,000.00	200,000.00
54374 Asfaltimi në Kuzmin Rruga „Toza Markovic,		10,000.00	-	-	10,000.00
55821 Asfaltimi në Fushë-Kosovë: Rugët,"Mirenet", "Fehmi Lladrovci" dytësore-krah,"Avni Rustemi - dytësore		60,000.00	-	-	60,000.00
55822 Asfaltimi në Fushë Kosovë:"Lagjia 28 dhe "Lagjia 29" në rrugën "Pashko Vasa","Karl Helmreish","Konstadin Kristoforidhi"		60,000.00	-	-	60,000.00
55823 Asfaltimi në Grabovci; Rugët "Topi" rruga Sogojeva në Grabovc		35,000.00	-	-	35,000.00
55829 Asfaltimi në Bardh të Vogël:Rugët "Lisi","Bardhi		10,000.00	-	-	10,000.00
55838 Asfaltimi në Sllatin të Madhe:"Rruga e Pejës-dytësore","Dardhishta","Elena Gjika		10,000.00	-	-	10,000.00
55844 Asfaltimi në Sllatinë të Vogël:Rugët:"Tetori","Shpati"		10,000.00	-	-	10,000.00
55858 Asfaltimi në Vragoli,Rugët:"Mahalla e Lartë","9 Prilli","Livadheve","Lidhja e Pejës","7 Marsi"		10,000.00	-	-	10,000.00
55862 Asfaltimi në Miradi të Epërme:Rugët:"Bregu i Madh","Lumi","Gërvalla","Bylemeti"		10,000.00	-	-	10,000.00
55863 Asfaltimi në Harilaq:Rruga"Otava","Blinishta		10,000.00	-	-	10,000.00
55864 Asfaltimi në Henc:Rugët,"Liqeni","Abdyl Henci"		10,000.00	-	-	10,000.00
55866 Asfaltimi në Lismir:Rugët"Unaza Lot II","Ymer Sfarqa","Ejup Gashi"		50,000.00	-	-	50,000.00
55867 Asfaltimi në Pomozotin:Rruga"Kroi-Dytësore"1,2,3		10,000.00	-	-	10,000.00
55872 Asfaltimi në Miradi të Poshtme:Rugët"Miradi","Graqanka","Bllata","Bardhosh Gërvalla","Ylli i Dritës","Përtej Lumi","Gjin Gazulli","Konjusha		10,000.00	-	-	10,000.00
55873 Rregullimi i trotuareve dhe vendosja e pemeve te reja ne qytetin e Fushe Kosoves		35,000.00	-	-	35,000.00
55992 Rregullimi në rrugën Dardania FUSHË-KOSOVË(trotauret,ndriqimi,largimi i terrasave,sinjalizimi,infrastruktura elektrike)faza e I		200,000.00	-	191,000.00	391,000.00
56346 Asfaltimi në Bardh të madhe:"Nënhekurudha krah","UÇK Bardhi"		10,000.00	-	-	10,000.00
18162 Infrastruktura publike	0451				-
54193 Ndërtimi i rrugëve bujqësore me zhavor dhe kanaleve kulluese të ujërave atmosferike në Bardh i madh,Pomozotin,Bardh i vogel,Sllatin e madhe		40,000.00	-	-	40,000.00
54202 Rregullimi i nënkallimit (urës në Vragoli) Rr.e Pejës M9		50,000.00	-	-	50,000.00
56226 Ndërtimi i kanalizimeve atmosferike në Fushë Kosovë		10,000.00	-	-	10,000.00
56231 Ndërtimi i kanalizimeve dhe ujësjellësit në fshatrat :Harilaq,Graboc dhe në Fushë-Kosovë lagjen 028		250,000.00	-	116,333.42	366,333.42
56283 Ndërtimi i rrethojës në varrezat e reja në Miradi e Epërme		10,000.00	-	-	10,000.00
56435 Ndriqimi publik në rrugët Hajrullah Zymi,Enver Maloku,dhe Hamdi Grajqevci në Fushë-Kosovë		60,000.00	-	-	60,000.00
48002 Planifikimi dhe zhvillimi ekonomik	0411				
56085 Tabela informuese -Promovimi i turizmit lokal (në Rruga e Pejës,Nënë Teresa në Fushë-Kosovë dhe në fshatin Sllatinë e Vogël te pishat)		10,000.00	-	-	10,000.00
56109 Sistemi Solar në institucionet e Administratës,QKMF-së,Arsimit		70,000.00	-	-	70,000.00

66015 Planifikimi Hapesinor dhe rregullative	0620		-	-	
49732 NDERTIMI I KANALIZIMIT DHE UJËSJELLSIT (FSHATRA, QYTET)			-	660,166.58	660,166.58
73011 ADMINISTRATA Shëndetësi	0760		-	-	
55999 Blerja e kondicionereve për shëndetësi QKMF,QMF,AMF		40,000.00	-	-	40,000.00
73150 Shërbimet e shëndetësisë primare	0721		-	-	
56001 Blerja e gjeneratorit QKMF		15,000.00	15,000.00	-	30,000.00
56004 Rregullimi i oborrit QMF-së në fshatin Miradi e Ultë,Fushë-Kosovë		20,000.00	20,000.00	-	40,000.00
85002 Shërbimet kulturore	0820				
55932 Rregullimi i stadiumit ne Sllatine te Madhe		10,000.00	-	-	10,000.00
55933 Renovim i stadiumit ne Bardh te Madh		10,000.00	-	-	10,000.00
55934 Renovimi i stadiumit ne Miradi te Eperme te objektit i Shkolles Fillore		10,000.00	-	-	10,000.00
55935 Rregullimi i stadiumit ne Lismir		10,000.00	-	-	10,000.00
55952 Renovimi i objektit te shkolle per arkive- Pomozotin		40,000.00	-	-	40,000.00
55960 Ndërtimi i pllakave memoriale (në varrezat e Deshmoreve në Fushë-Kosovë)		20,000.00	-	-	20,000.00
56314 Renovimi dhe zgjerimi i stadiumit të qytetit faza e dytë		80,000.00	-	-	80,000.00
92010 Administrata Arsimit	0980				
55848 Blerja e pajisjeve për shkollat - Mihail Grameno, Selman Riza, Vilezerit Frashëri		50,000.00	-	-	50,000.00
56438 Dixhitalizimi në objektet shkollore në Shkollat Fillore "Mihal Grameno","Selman Riza","Daut Bogujevci","Hivzi Sylejmani" në Fushë-Kosovës dhe Shkollën Fillore Vëllezeri		10,000.00	-	-	10,000.00
92230 Arsimi parashkollor	0911				
54303 Ndertimi i Çerdhes ne Fushe Kosove rr.Shukrije Obertinca		230,000.00	230,000.00	-	460,000.00
55898 Ndertimi i Cerdheve ne Sllatine te madhe dhe Miradi e Eperme		100,000.00	100,000.00	-	200,000.00
93030 Arsimi fillor, i mesëm i ulët	0912				
54302 Ndertimi i Shkolles Fillore ne Fushe Kosove rr.Fazli Grajqevci		340,000.00	340,000.00	-	680,000.00
55881 Ndertimi i shkalleve emergjente ne shkollat: "Mihal Grameno" Aneksi I, "Mihal Grameno" Aneksi II në Fushë-Kosovë		10,000.00	10,000.00	-	20,000.00
55889 Rregullimi i oborrit të shkollës fillore "Mihal Grameno" Aneksi III, rr.Amir Elmazi		26,000.00	26,000.00	-	52,000.00
94230 Arsimi i mesëm i lartë	0922				
55868 Renovimi i objekteve shkollore: "Selman Riza", Laura Scotti", "Mihal Grameno" Aneksi I në Fushë-Kosovë		70,000.00	70,000.00	-	140,000.00



Heute/En





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO POLJE



Datë: 23.09.2025

Kuvendi i Komunës së Fushë-Kosovës në mbledhjen e mbajtur me datën 18.09.2025, e vazhduar me datën 22.09.2025, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 713, të datës 22.07.2025, të paraqitur nga Drejtorisë së Planifikimit Urban, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa, bazuar në nenin 11, nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (l), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 13, nenin 14, të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr. 03/L-049, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 22, paragrafi 1, nenin 23, të Ligjit për Ndërtim Nr. 04/L-110, (Gazeta Zyrtare Nr. 18/2012), nenin 4, nenin 5, nenin 10, nenin 11, nenin 12, të Udhëzimit Administrativ për taksat administrative për leje ndërtimore, leje rrënim dhe tarifave për rregullimin e infrastrukturës Nr. 02/2018, nenin 12, paragrafi 12.1, shkronja (ç, nj), nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (ç), nenin 27, shkronja (nj), nenin 54, shkronja (dh, f) të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për miratimin e Propozimit Nr. 713, të datës 22.07.2025, për caktimin e taksës administrative për leje të ndërtimit, leje të rrënit dhe tarifës rregullative për rritjen e densitetit në Infrastrukturë për vitin 2025

1. Për miratimin e Propozimit Nr. 713, të datës 22.07.2025 për caktimin e taksës administrative për leje të ndërtimit, leje të rrënit dhe tarifës rregullative për rritjen e densitetit në Infrastrukturë në vitin 2025 si vijon:
 - 1.1 Taksa administrative për lëshimin e lejeve ndërtimore në shumë prej: 1.57€ për një metër katror në kategorinë e parë;
 - 1.2 Taksa administrative për lëshimin e lejeve ndërtimore në shumë prej: 1.80€ për një metër katror në kategorinë e dytë;
 - 1.3 Taksa për rritjen e densitetit në infrastrukturë për kokë banori do të jetë 422.70€, me kosto për një metër katror në shumë totale prej: 8.45€ dhe
 - 1.4 Taksa administrative për leje të rrënit në shumë prej: 1.46€ për një metër katror.
2. Miratimi i taksave administrative dhe taksa për rregullimin e densitetit në infrastrukturë për vitin 2025, mbështetet në shkresën e Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës me Nr. 4003-2/25, të datës 14.06.2025.
3. Objektet publike institucionale që financohen nga institucionet shtetërore lirohen nga taksat për leje ndërtimore.

4. Llogaritja e taksave administrative për leje ndërtimore të kategorisë së parë dhe të kategorisë së dytë, leje të rrënit dhe taksa për rregullimin e densitetit në infrastrukturë, bëhet duke u mbështetur në pikën një të këtij vendimit.
5. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera, për zbatimin e vendimit, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë së Planifikimit Urban.
6. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së PU dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Ali Ismaili



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE
DIREKTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJO

Ulag/Dr. str. 99
Datë/Catim. 24. 09. 2025
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 23.09.2025

Kuvendi i Komunës së Fushë-Kosovës në mbledhjen e mbajtur me datën 18.09.2025, e vazhduar me datën 22.09.2025, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 778, të datës 18.07.2025, të Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik, lidhur me 'Projekt-Strategjinë për Zhvillim Ekonomik Lokal të Komunës së Fushë-Kosovës për vitet 2025-2029', të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetit për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (d), nenin 17, shkronja (a), nenin 40, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (ç), nenin 27, të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për aprovimin në parim për diskutim publikë të Projekt-Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal për vitet 2025-2029

1. Për aprovimin në parim për diskutim publikë të 'Projekt-Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal të Komunës së Fushë-Kosovës për vitet 2025-2029'.
2. Projekt-Strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal të Komunës së Fushë-Kosovës për vitet 2025-2029, e cekur në pikën një të këtij vendimi, cakton objektivat për zhvillim ekonomik për periudhën pesë vjeçare në territorin e komunës.
3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Projekt-Strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal të Komunës së Fushë-Kosovës për vitet 2025-2029.
4. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi dhe mbajtjen e diskutimit publikë, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik.
5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së ZHE dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Ali Ismaili





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 23.09.2025

Kuvendi i Komunës së Fushë-Kosovës në mbledhjen e mbajtur me datën 18.09.2025, e vazhduar me datën 22.09.2025, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 926, të datës 27.08.2025, të paraqitur nga Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim, lidhur me 'Projekt-Planin e Veprimit Komunal për avansimin e të drejtave të komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptian të Komunës së Fushë-Kosovës për vitet 2025-2027', të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (d), nenin 17, shkronja (s), nenin 40, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (ç), nenin 27, të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për aprovimin në parim për diskutim publikë të Projekt-Planin e Veprimit Komunal për avansimin e të drejtave të komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptian të Komunës së Fushë-Kosovës për vitet 2025-2027

1. Për aprovimin në parim për diskutim publikë të 'Projekt-Planin e Veprimit Komunal për avansimin e të drejtave të komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptian të Komunës së Fushë-Kosovës për vitet 2025-2027'.
2. Projekt-Planin e Veprimit Komunal për avansimin e të drejtave të komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptian të Komunës së Fushë-Kosovës për vitet 2025-2027', e cekur në pikën një të këtij vendimi, cakton objektivat për avansimin e të drejtave të komuniteteve për periudhën tre vjeçare në territorin e komunës.
3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Projekt-Planin e Veprimit Komunal për avansimin e të drejtave të komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptian të Komunës së Fushë-Kosovës për vitet 2025-2027.
4. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi dhe mbajtjen e diskutimit publikë, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës dhe Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim.
5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorive të Komunës, Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Ali Ismaili

